



Planuar / Diturum Planned / Known Received / Delivered	05-12-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Dr. Prof. Dr. / Prof. Prof. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPINSTAK 7681/2022			1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.743/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2658/2021 të datës 31.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.743/2021 të datës 20.08.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson

kundër Vendimit me numër protokollit 0262 të datës 21.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa më numër A.nr.743/2021 e datës 20.08.2021 e parashtruar nga ankuesi *si e pabazuar.*
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 0262 i datës 21.07.2021 i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës dhe përfaqësuesit të tij, më datë 19.08.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 20.08.2021 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.743/2021 me numër protokollit 4288/2021, kundër Vendimit me numër protokollit 0262 të datës 21.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Ndërsa Këshilli më datë 06.09.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa përfaqësuesi i ankuesit më datë 05.10.2021 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.10.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2658/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 05.10.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 20.08.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.08.2021 me numër protokoll 4288/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 12.08.2021; Vendimin me numër protokoll 0262 e datës 21.07.2021 të Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror; Zarin e datës 19.08.2021; Kërkesën për Përgjigje në ankesë e datës 23.08.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 06.09.2021; Akt Emërimit e datës 04.04.2017 të ankuesit; E-mailin e datës 21.07.2021 nga [] për ankuesin; E-mailin e datës 23.06.2021 dhe 28.06.2021 nga [] E-mailin e datës 29.06.201 nga [] për [] E-mailin e datës 29.06.2021 nga [] për ankuesin dhe [] Procesverbalet e datës 05.07.2021 për takim të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 01.07.2021 të ankuesit për [] E-mailin e datës 02.07.2021 të [] për [] E-mailin e datës 07.07.2021 nga [] për [] E-mailin e datës 07.07.2021 nga [] për [] E-mailin e datës 07.07.2021 nga [] për ankuesin; E-mailin e datës 15.07.2021 nga [] për ankuesin; Procesverbalet e takimit të Komisionit Disiplinor të datës 14.07.2021; E-mailin e datës 22.06.2021 nga [] Inicimin e procedurës disiplinore i datës 22.08.2021; Njoftimin mbi dyshimin për shkelje disiplinore i datës 24.05.2021; Vendimin e datës 28.03.2019 për pushim pa pagesë të ankuesit; Kërkesën për vazhdimin e pushimit pa pagesë e datës 20.12.2019 të ankuesit; Vendimin e datës 27.02.2020 për vazhdimin e afatit për pushim pa pagesë; Kërkesën për vazhdimin e pushimit pa pagesë e datës 05.08.2020 të ankuesit; Vendimin e datës 08.09.2020 për vazhdimin e afatit për pushim pa pagesë; Kërkesën për vazhdimin e pushimit pa pagesë e datës 20.02.2019 të ankuesit; Njoftimin për afatin e fundit për paraqitje në punë i datës 15.02.2021 nga [] për ankuesin; Listën e vajtje/ardhje në punë për periudhën 01.05.2021 deri 22.06.2021; E-mailin e datës 06.07.2021 nga [] E-mailin e datës 06.07.2021 nga [] E-mailin e datës 12.07.2021 nga [] Njottimin e datës 05.10.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.2658/2021 të datës 31.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesit, ka qenë i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.04.2017 në pozitën “Mbikëqyrës i Ndërrimit Kullë/Vajtje Ardhje” në Agjencisë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Të njëjtit sipas Vendimit me Nr. Prot:2151 të datës 28.03.2019 i është lejuar pushimi pa pagesë për periudhën një (1) vjeçare nga data 07.03.2019 deri më datë 06.03.2020, mirëpo ankuesi sipas kërkesës 20.12.2019 ka kërkuar vazhdimin e pushimit pa pagesë deri më datë 01.09.2020. Me Vendimin me Nr. 18/2020 të datës 27.02.2020 i është vazhduar pushimi pa pagesë deri më datë 01.09.2020. Po ashtu ankuesi sipas kërkesës të datës 05.08.2020 ka kërkuar vazhdimin e pushimit pa pagesë deri më datë 03.04.2021, ndërsa sipas Vendimit me Nr.30/20 të datës 28.09.2020 ankuesi i vazhdohet pushimi pa pagesë deri më datë 03.04.2021.

Më datë 15.02.2021 përmes e-mailit Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ka njoftuar ankuesin se afati për paraqitje në punë është data 01.05.2021.

Më datë 24.05.2021 Menaxheri i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka bërë njoftimin që bazuar në situatën me Covid-19, ankuesi ka qenë i obliguar që të paraqitet në punë më datë 01.05.2021, ndërsa bazuar në të gjitha të dhënat si dhe bazuar në planifikimin e orarit të punës si dhe prezencën në punës i njëjti as nuk ka njoftuar që dëshiron të kthehet në punës si dhe nuk janë evidentuar në prezencë elektronike në punë, andaj bazuar në këtë dyshohet për shkelje disiplinore. Bazuar në këtë më datë 22.06.2021 nga Menaxheri i ATS është iniciuar procedura disiplinore pranë Komisionit Disiplinor për ankuesin me arsyetimin që sipas njoftimit të Burimeve Njerëzore ankuesi ka munguar në punë duke mos arsyetuar mungesën e tij, kështu që ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, më datë 21.07.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:0262 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 0262 të datës 21.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, pretendon se njoftimin për paraqitje në punë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse njoftimi është dërguar në e-mailin zyrtar të ankuesit ndërsa gjatë pushimit pa pagesë nuk ka pas çasje në e-mail zyrtar. Vendimi i Komisionit Disiplinor nuk konsiston në gjendje faktike sepse ankuesi gjatë kësaj kohe ka qenë jashtë vendit në trajnim në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe nuk ka mund të udhëtoj para datës 22.07.2021 sepse Kosova ka qenë në listën e vendeve që nuk lejohej të udhëtohej, andaj vendimi për largim nga shërbimi civil është nxjerr në kundërshtim Ligjin për Zyrtarët Publikë sepse kjo masë vjen në shprehje vetëm kur ke masa tjera disiplinore dhe janë të pashlyera.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Neni 45 ka përcaktuar se: "... Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përniban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"

Neni 46 ka përcaktuar se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delur në punë

Neni 47 ka përcaktuar se: "1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Andaj përkitazi me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi për lejimin e pushimit pa pagesë është fakt notor, si rrjedhojë ankuesi është dashur që të ketë parasysh përfundimin e pushimit pa pagesë, dhe në rastin konkret të paraqitet në vendin e tij të punë apo është dashur që të njoftojë institucionit për arsyet e mosparaqitjes në punë, ndërsa meqenëse ankuesi ka pasur për obligim të paraqitet në vendin e tij të punës pas kalimit të afatit të pushimit pa pagesë, institucioni nuk ka pasur asnjë obligim ligjor që të njoftoj ankuesin për paraqitjen e tij në punë, mirëpo këtë e ka bërë me mirëkuptim dhe mirësjellje. Në rastin e njoftimit të ankuesit për paraqitje në vendin e punës sipas e-mailit të datës 15.02.2021, kemi respektim të plotë të nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Njoftimi i një dokumenti të shkruar (në vijim: shkresa), kryhet nëpërmjet dërgimit me postë, në mënyrë elektronike apo nëpërmjet njoftimit formal sipas këtij Ligji", sepse ankuesi është njoftuar përmes e-mailit të tij zyrtar, kështu që pretendimi i ankuesit se njoftimi për paraqitje në punë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i paqëndrueshëm, sepse pretendimi i ankuesit se meqenëse ka qenë jashtë vendit dhe nuk i ka funksionuar e-maili zyrtar është fakt i pa vërtetuar sepse në emailin e njëjtit të ankuesit i njëjti është njoftuar për takimet e Komisionit Disiplinor dhe për procesverbalet po ashtu edhe ankuesi me të njëjtin e-mail ka kontaktuar me z. më datë 01.07.2021. Po ashtu ankuesi në procesverbalin e takimit të

Komisionit Disiplinor të datës 05.07.2021 në pyetjen e një anëtarit të komisionit lidhur me e-mailin e datës 15.02.2021 për tu paraqitur në punë është përgjigjur: *"...Ky është lëshim nga ana ime gjithmonë duke shpresu se do të vijë, mirëpo duke marr parasysht pandeminë, e kam pas të panundur të jem atje. Pse nuk kam komunku, gjithmonë kam shpresu se do të jem fizikisht atje"*, me këtë fakt ankuesi ndër tjera pranon se ka pranuar njoftimin e datës 15.02.2021 mirëpo me shpresë që do të kthehet nuk ka gjetur kohë për të komunikuar me shkrim.

Meqenëse ankuesi nuk është paraqitur në vendin e tij të punës pas kalimit të kohës së pushimit pa pagesë, dhe me vetë faktin që nuk ka arsyetuar mungesën e tij në punë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konsideron që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës duke munguar në punë për pesë (5) ditë e më tepër, kështu që ankuesi me veprimet për mosparaqitje në vendin e tij të punës ka vepruar në kundërshtim me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"zyrtari publik ka detyrë të vepronte në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit"*, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji përcaktohet se: *"zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*, po ashtu ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Shkelje të rënda konsiderohen: braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë"*, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, si rrjedhojë Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 0262 të datës 21.07.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"*, ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat e administruara, po ashtu ka marr për bazë edhe deklarimet e ankuesit në procesverbalet e takimit të Komisionit Disiplinor të datës 05.07.2021 dhe 14.07.2021.

Bazuar në provat e administruar dhe faktet juridike vendimtare, Kolegji, konstaton se Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokollit 0262 të datës 21.07.2021, ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit*, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 4.1 dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.743/2021

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit ligjor të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.